# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-467292**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Plani Hapësinor 2040 në shënjestër të kritikave, "Zdrava Kotlina" paralajmëron rreziqe nga minierat e reja |
| ADRESA | `https://albeu.com/maqedoni/plani-hapesinor-2040-ne-shenjester-te-kritikave-zdrava-kotlina-paralajmeron-rreziqe-nga-minierat-e-reja/1026371/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 20:17:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 20:16:24 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0bab89140fc27e9b1422226daab94872e39bb6ecb214f046be672c4b6c392c76` |
| TEKSTI | `9a060a3ba20ac20d7a1ccad7ac031412702b4aaba2d0a8cbce49663c35063206` |
| PAMJA | `490321c6cefb9984a10f281669e90b796de958198f3ab876bdb0dc49b0377409` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bf9e9fb5fc9c4775ff249533e995dd89f3e3d6c6b4cb54b07de89bd9935347ec` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `de40688aeff4cba129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bf9e9fb5fc9c4775ff249533e995dd89f3e3d6c6b4cb54b07de89bd9935347ec`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Plani Hapësinor 2040 në shënjestër të kritikave, “Zdrava Kotlina” paralajmëron rreziqe nga minierat e reja




Projekt-Plani Hapësinor 2040 për Rajonin Planor Juglindor ka ngjallur shqetësim në një segment të opinionit, sidomos për shkak të perspektivës së hapjes së minierave të reja dhe pasojave potenciale mbi bujqësinë dhe ekosistemin.

Organizata qytetare “Zdrava Kotlina” u ka bërë apel qytetarëve për një mobilizim të gjerë kundër këtyre projekteve minerare. Sipas tyre, masat e parashikuara në draft hapin rrugën për shndërrimin e tokës në zona të industrisë së rëndë, G1, duke tërhequr vëmendjen mbi rreziqet që i kanosen tokave bujqësore dhe ambientit jetësor.

Në komunikatën e shoqatës “Zdrava Kotlina” sqarohet se “Vetëm fakti që një lokacion apo lëndë minerale figurojnë në dokumentacionin hapësinor-planor nuk nënkupton automatikisht se aty do të ngrihet një minierë. Për të çuar përpara një projekt konkret minerar nevojiten faza të mëtejshme, autorizime dhe plotësim i kornizës ligjore”.

Një prej pikave kyçe për Fushën e Strumicës, nënvizon shoqata, mbetet ruajtja e burimeve ujore. Ata bëjnë me dije se gjatë hartimit të planit janë përfshirë sektorë që kanë të bëjnë me administrimin e ujërave, zhvillimin bujqësor, mbrojtjen e natyrës, infrastrukturën dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Edhe LSDM ka sinjalizuar se do të pengojë miratimin e këtij plani të ri hapësinor. Lideri i LSDM-së, Venko Filipçe, u shpreh se Maqedonia nuk është objekt tregtie dhe se shteti nuk mund të sakrifikohet për interesa të ngushta që dëmtojnë shëndetin publik, duke insistuar në tërheqjen e draftit.

Prej kohësh, partia “E Majta” po kërkon instalimin e një moratoriumi për koncesionet e reja dhe për çdo procedurë që lidhet me minierat në perspektivë. Deputeti Borislav Krmov deklaroi se është e palejueshme të

të fundit/


Aksident fatal në Itali, 51-vjeçari shqiptar humb jetën pasi bie n…


I riu nga Kosova pranon fajin në SHBA për operimin e tregut të…


Thirrje për arrestimin e Ramës dhe Ballukut, protestuesit vazhdojn…


Demonstatat shtrihen në natën e nëntë, nismëtarët njoftojnë…


Vlora Hyseni në GJKKO, mohon dhënien e materialev…


Zëvendëskryeministri Sali takohet me kryeministrin kroat…


Takimi mes Bekim Salit dhe Albin Kurtit në Nju Jork: Maqedonia e…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

procedurë që lidhet me minierat në perspektivë. Deputeti Borislav Krmov deklaroi se është e palejueshme të vihet në lojë mjedisi jetësor dhe pasuria natyrore.

Nga ana e saj, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka njoftuar më herët opinionin se ka nisur raundi i diskutimeve publike rajonale për Draft-Planin Hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2040.

Ministria thekson se këto konsultime përfaqësojnë një rast për t'u familjarizuar me propozimet planore, si dhe për të paraqitur sugjerime dhe kritika gjatë procesit të finalizimit të një prej dokumenteve strategjikë më jetikë për zhvillimin hapësinor të vendit.

Shtuar më 24.09.2026 22:16

Tags: Minierat në maqedoni



Zëvendëskryeministri Sali takohet me kryeministrin kroat Plenković gjatë…


Takimi mes Bekim Salit dhe Albin Kurtit në Nju Jork: Maqedonia e Veriut dhe…


Arta Bilalli Zendeli: Rikthimi i Izet Mexhitit në BDI nuk është fantazi


Petrovska: Për dy vite diskutuam brenda LSDM-së, propozimet dhe…


Deputetja Llukarevska i bën thirrje ministrit Serafimovski: Të dalë në…


Pohimi "Maqedonia 73 vjet, shqiptarët 3000 vjet" rindez përplasjet mbi të kaluarën


Janevska: Brenda dy vitesh, arsimi mori 70 milionë euro investime


Analiza e Hodait: Transporti për studentët në Maqedoni, 2-3 herë më i kushtueshë…



albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko



**Kryesore**

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.